



OSHEE
OPERATORI I SHPËRNDARJES
SE ENERGJISE ELEKTRIKE

DREJTORIA E QEVERISJES SË KOORPORATËS





Version 1.0

Nr. 22228 Prot. 11-12-2015

POLITIKA E RISKUT NË OSHEE SH.A..

Version 1.0

DREJTORIA E QEVERISJES SË KOORPORATËS

Roli	Pozicioni	Emri Mbiemri	Firma	Data e Firmosjes
Sektori i Administrimit te Riskut	Shefe Sektori	Jonida Çetaj		09/12/2015
Mbikëqyrësi i dokumentacionit	Drejtoria e Qeverisjes së Koorporatës	Ermal Gjinaj		09/12/2015
Sektori i Dokumentimit të Proçeseve dhe Përputhshmërisë	Shefe Sektori	Erina Rexhepi		09/12/2015
Pjesëmarrës në përshkrimin e proçeseve	Specialist Sektori i Administrimit te Riskut Njësia e Qeverisjes së koorporatës	Edon Simaku Viola Kora Besiana Palluqi		09/12/2015
Struktura përgjegjëse për dokumentacionin	Sektori i Administrimit të Riskut	Jonida Çetaj		09/12/2015
Autorizuesi I-rë	Drejtori i DZHB	Altin Uka		11/12/2015
Autorizuesi i II-të	-	-		11/12/2015
Autorizuesi final	Administratori	Adrian Çela		11/12/2015

Drejtori i Drejtorisë/Departamentit/ Divisionit përkatës, në përpunohje me detyrat e tij funksionale, siguron zbatimin e rregullores së mëposhtme. Zbatimi korrekt i të gjitha pikave të kësaj rregulloreje është subjekt i kontrollit nga Auditi i Brendshëm i shoqërise. Respektimi i rregullave të punës do të monitorohet dhe çdo sjellje në kundërshtim me to do të jetë subjekt i masave disiplinore.

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	4
2.	APLIKIMI	4
3.	QËLLIMI	4
4.	FJALORI I TERMAVE	5
5.	ROLET DHE PERGJEGJESITE	6
5.1	Rolet e Menaxhimit të Riskut.....	6
5.1.1	Sektori i Administrimit të Riskut.....	6
5.1.2	Zotëruesi i Riskut	7
5.1.3	Zotëruesi i Proçesit	7
6.	PROÇEDURA	8
6.1	Kategorizimi i riskut në OSHEE SH.A.....	8
6.1.1	Risku Financiar	8
6.1.2	Risku i biznesit	13
6.2	Administrimi i Riskut.....	15
6.2.1	Objektivat e Manaxhimit të Riskut	15
6.2.2	Përcaktimi i kontekstit	16
6.2.3	Procesi i vlerësimit të Riskut	16
6.2.4	Trajtimi i Riskut.....	17
6.2.5	Komunikimi dhe konsultimi	17
6.2.6	Monitorimi dhe rishikimi	17
7.	ANEKSET	18
	ANEKS 1 Rregjistri i Riskut.....	18
	Aneksi 2 – Kategoritë dhe klasifikimet e riskut.....	22
	Aneksi 3 – Risku Operacional – Saktesime dhe shembuj konkret.....	24
8.	BAZA LIGJORE	27
9.	HISTORIKU I RISHIKIMEVE TË DOKUMENTIT	28

1. HYRJE

Ky dokument përcakton standartet që duhen përdorur në OSHEE SH.A.. për të administruar Riskun që i kanoset shoqërisë gjatë kryerjes së aktivitetet e saj të përditshme. Dhënia e rëndësisë që i takon Administrimit të Riskut, përbën një pjesë vitale për arritjen e Vizionit dhe Misionit të shoqërisë OSHEE sha.


2. APLIKIMI

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë strukturat e OSHEE SH.A.

3. QËLLIMI

Ky dokument ka për qëllim të theksojë rëndësinë e menaxhimit të riskut brenda shoqërisë OSHEE SH.A., të mbështesë stafin, për të kuptuar rolet e tyre dhe për të patur një qasje të qëndrueshme ndaj menaxhimit të riskut dhe të sigurojë krijimin e sistemeve dhe proceseve të duhura për administrimin e riskut në OSHEE SH.A.

Administrimi i Riskut Linja e dytë Mbrotjtëse e Njësisë Organizative



4. FJALORI I TERMAVE

“Risku” - Mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të një njësie organizative apo të shoqërisë në tërësi.

“Menaxhimi i Riskut” është pranimi dhe administrimi efektiv i të gjitha risqeve dhe mundësive, që mund të kenë impakt në reputacionin e një shoqërie, aftësinë e saj për të përbushur përgjegjësitë dhe detyrimet, si dhe arritjen e objektivave të saj.

“Vlerësim i Riskut” - Proçesi i krahasimit të rezultateve të analizës së riskut me kriteret e riskut, për të përcaktuar nëse risku dhe/ose madhësia e tij, janë të pranueshëm, ose të tolerueshëm.

“Zotëruesi i Riskut” - është personi brenda një njësie organizative, i cili ka autoritetin dhe është përgjegjës për administrimin e riskut, brenda njësisë së tij.

“Zotëruesi i Proçesit” – është personi, i cili ka përgjegjësinë parësore për kryerjen e një proçesi, në realizimin e objektivave të tij të matura përmes treguesve kryesorë të proçesit, dhe ka autoritetin dhe aftësinë për të bërë ndryshimet e nevojshme.

“Politikë” – jep parimet bazë që udhëheqin shoqërinë, për çështje apo proçese specifike. Këto parime përdoren si guidë gjatë vendim-marrjeve të caktuara.

“Probabiliteti” – është shansi që diçka mund të ndodhë. Ai mund të përcaktohet, vendoset apo matet në mënyrë objektive, ose subjektive, dhe mund të shprehet ose në mënyrë cilësore, ose sasiore (duke përdorur matematikën).

“Palë e Interesuar” – Një person apo një organizatë që mund të ndikojë apo mund të ndikohet nga një vendim apo një aktivitet. Palët e interesuara përfshijnë gjithashtu ata që kanë një perceptim, se një vendim apo një aktivitet mund të ndikojë tek ta. Palët e interesuara mund të jenë të jashtme, ose të brendshme.

“Risk i Mbetur” – është Risku që mbetet pasi ke implementuar një mënyrë të trajtimit të Riskut. Është Risku që mbetet pasi ke reduktuar Riskun, ke eleminuar burimin e Riskut, modifikuar pasojat e Riskut, ke ndryshuar probabilitetin, ke transferuar Riskun, ose ke mbajtur Riskun.

Akronime:

DQK	Drejtoria e Qeverisjes së Korporatës
KSH	Këshilli Mbikëqyrës
SAR	Sektori i Administrimit të Riskut

5. ROLET DHE PERGJEGJESITE

Çdo njësi organizative duhet të kryejë një vlerësim të vazhdueshëm dhe të plotë të riskut brenda njësisë dhe duhet t’ia përcjellë atë SAR. Është përgjegjësi e të gjithë stafit që të ruajë ndërgjegjësimin për Risqet, si dhe të identifikojë dhe raportojë risqet tek zotëruesi përkatës i Riskut.

5.1 Rolet e Menaxhimit të Riskut

5.1.1 Sektori i Administrimit të Riskut

Sektori i Administrimit të Riskut (SAR) lehtëson, koordinon dhe këshillon për procesin e menaxhimit të riskut, për të ndihmuar Njësitë në menaxhimin e riskut në mjeshtëri e tyre, në një mënyrë që është konsistente për të gjithë OSHEE SH.A.. Megjithatë, SAR nuk kryen menaxhim risku në emër të Njësive, apo nuk merr përsipër zotërimin, apo përgjegjësinë, për ata risqe. Përgjegjësi i SAR raporton tek Drejtori i Drejtorisë së Qëvërisjes së Korporatës.

Përgjegjësitë:

- ❖ Të konsultohet me Njësitë, për të identifikuar dhe analizuar risqet dhe për të përcaktuar veprimet që mund të ndërmarrën për zbutjen e tyre;
- ❖ Të mirëmbajë në vazhdimësi Regjistrin e Riskut;
- ❖ Të raportojë në mënyrë periodike tek Komiteti i Riskut, Hartën e risqeve të identifikuara.

- ❖ Të promovojë Politikën e Menaxhimit të Riskut, procedurat dhe praktikat më të mira brenda OSHEE SH.A.;
- ❖ Të komunikojë ndryshimet në Politiken e Menaxhimit të Riskut dhe procedurat respektive;
- ❖ Të ndajë informacionin dhe njohuritë për risqet në brendësi të organizatës;
- ❖ Të jetë pika qëndrore e kontaktit për drejtuesit e OSHEE SH.A., në lidhje me administrimin e riskut dhe përputhshmërisë me këtë Politikë
- ❖ Të mbështesë Komitetin e Riskut, duke garantuar implementimin e politikës së menaxhimit të riskut, si dhe administrimin e regjistrat të riskut të OSHEE SH.A.

5.1.2 Zotëruesi i Riskut


Çdo njësi do të kenë një Zotërues të Riskut të identifikuar, i cili është përgjegjës për të siguruar administrimin e riskut, ndërmarrjen e kontrolleve dhe veprimeve të vazhdueshme për të zbutur riskun, monitorimin e vazhdueshëm të riskut, si dhe raportimin në lidhje me statusin e përgjithshëm të riskut brenda njësisë së tij. Është përgjegjësi e Zotëruesit të Riskut që të përcjellë më lart në hierarki risqet atëherë kur duhet, në përputhje me procedurat e riskut. Për risqet e identifikuar nga një Njësi, që kanë ndikim në fusha apo Njësi të tjera të OSHEE SH.A., Zotëruesi i Riskut raporton menjëherë tek SAR.

5.1.3 Zotëruesi i Proçesit

Çdo njësi ka një ose më shumë Zotërues të Proçesit, tek i cili Zotëruesi i riskut ka deleguar përgjegjësinë, për të siguruar përbushjen e një detyre apo aktiviteti që do të ndihmojë për të zbutur riskun, si dhe ofruar raportim të rregullt në lidhje me progresin e bërë.

6. PROÇEDURA

6.1 Kategorizimi i riskut në OSHEE SH.A..



6.1.1 Risku Financiar

Risku financiar lidhet me humbjet që mund të vijnë nga aktivitetet financiare. Llojet e riskut financiar janë:

a. Risku i Tregut

Risku i tregut është rreziku i humbjes së vlerës së aksionerëve, që buron nga ndryshimet e kushteve të tregut, veçanërisht nga ndryshimet e çmimeve të tregut dhe volumit të kërkesës së mallrave, produktive ose shërbimeve. Risqet e tregut janë:

Risku i Monedhës (monetar)/Valutës

Risku i monedhës specifikon riskun që mund t'i kanoset shoqërisë nga pikëpamja financiare, si edhe kapitalit të saj, të shkaktuara këto nga ndryshimet e kursit të këmbimit, (ndryshimet në asetet ose detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj). Ekzistojnë dy lloje të Riskut të Monedhës: Risku nga transaksionet (i transaksionit) dhe risku nga kursi i këmbimit:

- 1) Risku i transaksionit ka të bëjë me riskun e kalimit të cash - floë-t aktual nga valuta të ndryshme, dhe se sa këto ndryshime nga kursi i këmbimit, do të ndikojnë në cash floë-n e shoqërisë. Risku i kursit të këmbimit buron nga fakti që të ardhurat e shoqërisë, shumica e kredive të saj dhe llogarive të arkëtueshme janë në monedhën Lekë/ALL, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të saj, janë në monedhë të huaj. Risku kryesor është se vlera e monedhës të fluksit të parasë që vjen nga shlyerjet e detyrimeve dhe interesat përkatëse varion, si rezultat i luhatjeve në kursin e këmbimit, gjë që mund të ndikojë ndjeshëm në fitimet e shoqërisë.
- 2) Risku nga kursi i këmbimit lidhet më së shumti me kontabilitetin. Ai përfshin ndikimin e kursit të këmbimit mbi fitimet dhe zërat e bilancit, gjatë prezantimit të pasqyrave financiare.

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit çon drejt ndryshimit të vlerës reale të aseteve ose detyrimeve monetare të rëndësisë të veçantë, ose drejt ndryshimeve të interesit

lidhur me kostot dhe të ardhurat, ose në kostot dhe të ardhurat që janë të ndjeshme ndaj normës së interesit të tregut.

Gjatë aktivitetit të përditshëm të biznesit, shoqëria merr hua që të financojë aktivitetin e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit, sepse vlera fikse e kursit të huamarrjes dhe fluksi i mjeteve monetare lidhur me luhatjet e kursit të huasë, do të reflektojë diferençat në normën e interest.

Risku i ndryshimit të çmimit të energjisë

Çmimi i energjisë elektrike është shumë më i paqëndrueshëm, se çmimi i mallrave të tjerë. Risku i ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike është rreziku që i kanoset shoqërisë nga pikëpamja financiare, si dhe kapitalit të saj, të shkaktuara këto nga ndryshimet e çmimit të energjisë. Ndryshimet afatshkrutër apo afatgjatë të çmimit të energjisë ndikojnë drejtperdrejtë tek të ardhurat e kompanisë. Jo vetëm kompania preket negativisht nga luhatjet e ndryshimit të çmimit të energjisë, por gjithashtu dhe ekonomia, duke patur luhatje të GDP-së. Mundësia e lëvizjeve ekstreme të çmimeve të energjisë rrit Riskun Tregtar në tregjet e energjisë elektrike. Risku i ndryshimit të çmimit të energjisë sjell pasiguri në menaxhimin e kostove të shoqërisë, pamundësinë për të përbushur detyrimet, ndikime negative në stabilitetin e shoqërisë, dhe ndikime negative në reputacionin e shoqërisë.

b. Risku i Kreditimit

Risku i kreditimit është rizku nga efektet negative financiare që mund të vijnë si rezultat i mospagesave nga një biznes, partner kontraktual apo financiar; kjo nga mungesa e dëshirës, ose pamundësia që të përbushë detyrimet.

Llojet e riskut të kreditimit janë:

Risku i palës tjetër (kundërpertisë)

Risku i palës tjetër është çdo institucion finansiar ose publik, që konsiderohet si partner kontraktual i shoqërisë.

Risku nga mospagimi i debitorit

Ky risk është rishku i një humbjeje, që rezulton nga dështimi për të shlyer një detyrim finansiar kundrejt shoqërisë, të gjithin dhe në kohë, kjo si prej mungesës së dëshirës, ashtu edhe prej paaftësisë paguese të debitorit.

Risku nga mospagimi i furnitorit

Risku nga mospagimi i furnitorit është rishku nga një humbje që rezulton nga dështimi për të shlyer një detyrim, nga ana e furnitorit, kundrejt shoqërisë. Detyrimi i furnitorit zakonisht nuk është i natyrës financiare (psh përfundimi i një investimi), ku kompania ndodhet në pozitën e debitorit (që ka urdhëruar kryerjen e investimit).

Risku i marrëveshjes

Risku i një humbje që rezulton nga mospërbushja e një transaksiungi nga një palë tjetër, bazuar në një marrëveshje, në momentin kur vlera për t'u paguar nga shoqëria është kredituar në llogarinë e palës kontraktuese, ndërkohë që detyrimi nga pala tjetër nuk është përbushur ende. Lloji i marrëveshjes dhe kredibiliteti i palës tjetër janë faktorët kyç përcaktues të rishkut në këtë rast.

c. Risku i Likuiditeteve

Risku i likuiditeteve mund të përcaktohet si rishku me të cilin mund të përballet shoqëria për të përbushur detyrimet e saj financiare. Ekzistojnë dy lloje të rishkut të likuiditeteve:

- Mungesa e menjëherësme e likuiditeteve, që shkakton një rritje të kostos së financimit për volumin, monedhën dhe kohën e kërkuar. Rreziku konsiston në faktin se shoqëria nuk do të mund të përbushë plotësisht detyrimet e tashme dhe të ardhme të pagesave që ka për të kryer; dhe

- Rreziku i pamundësisë për të siguruar fonde shtesë, ose kur këto fonde mund të merren me norma të larta interesit në treg.

Shoqëria është e eksposuar ndaj një nevoje ditore për likuiditete te disponueshme, në mënyrë që të shlyejë detyrimet që rrjedhin nga shpenzimet operacionale të aktivitetit të saj të përditshëm. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në mbledhjen e detyrimeve ndaj abonentëve të saj. Kjo situatë shpesh çon në mospërputhje likuiditeteve në dalje me ato në hyrje, dhe për rrjedhojë, shfaqet rishku i likuiditetit.

d. Risku Operacional

Risku operacional është rishku i një humbjeje, si rezultat i proceseve të papërshtatshme ose të dështuara, të punonjësve apo sistemeve, ose nga ngjarje (faktorë) të jashtëm.

- Risku i procesit - është dështimi i proceseve ose sistemeve për shkak të konceptimit të gabuar të tyre, kompleksitetit ose mos-performimit, që çojnë në humbje operacionale.
- Risku i sjelljes - është impakti nga sjellja e punonjësve në kompani (efiqenca, shëndeti dhe siguria, ose besnikëria)
- Risku i jashtëm - janë ngjarje që ndodhin jashtë spektrit të aktiviteteve të shoqërisë, të cilat mund të kenë një ndikim në pasqyrat financiare, ose vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë, si psh fatkeqësitetë natyrore, dëmtimet e qëllimshme, pirateria informatike, ose mashtimi nga jashtë, si dhe nga vjedhjet.

6.1.2 Risku i biznesit

Risqet e biznesit janë ato risqe, të cilat shoqëria i merr përsipër me vullnet të plotë, në mënyrë që të krijojë një avantazh konkurruesh dhe t'i shtojë vlerë aksionerëve. Risku i biznesit përfshin vendimet (e biznesit) që merr shoqëria, dhe ambientin e biznesit në të cilin operon. Llojet risqeve të biznesit janë:

a. Risku Strategjik

Risku strategjik është risku që shfaqet si rrjedhojë e vendimeve kyçë për zhvillimin e biznesit të shoqërisë, psh nga vendimet për format (strukturën) e financimit, investimet dhe blerjet, nga prioritizimi i investimeve, nga çmimi dhe struktura (natyra) e produktit të shoqërisë.

b. Risku politik

Ky risk vjen nga niveli i zhvillimit të një rajoni, të sistemit ligjor, ekonomik dhe politik në të cilin shoqëria operon, duke përfshirë dhe nivelin e përgjithshëm të mjedisit të biznesit (tregut). Risku politik gjithashtu përfshin ndryshimet legjislativë (në të ardhmen), që mund të kenë ndikim në fitimet e shoqërisë.

c. Risku rregulator

Është risku i një humbje si rezultat i mospërputhshmërisë me një politikë të përcaktuar nga një autoritet rregulator, që rregullon tregun në një fushë të caktuar, bazuar në ligjet aktuale ose marrëveshjet ndërkombëtare. Ky risk buron nga pamundësia për t'u përshtatur me detyrat për dhënien e informacionit, raportimin dhe shkeljen e rregullores së detyrueshme, ose ligjeve.

d. Risku i reputacionit


Ky risk del si rezultat i një ngjarjeje ose serie ngjarjesh, të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e shoqërisë, duke reduktuar aftësinë për drejtimin (vazhdimin) e biznesit (aktivitetit) dhe që çon në:

- Dobësimin e fuqisë negocuese të shoqërisë për lidhjen e kontratave;
- Uljen e imazhit të shoqërisë;
- Rënie të interesit të investorëve.

e. Risku ligjor

Risku ligjor për biznesin mund të përkufizohet si dështimi që të: operojë brenda kufijve ligjorë, të jetë i ndërgjegjshëm për detyrimet ligjore, të respektojë angazhimet kontraktuale, të kompensojë furnitorët në rastet e mospagimit të detyrimeve në kohë, të dëshmojë që ka operuar brenda kufirit ligjor, ose të njohë dhe të menaxhojë në mënyrë efikase rreziqet ligjore.

6.2 Administrimi i Riskut



6.2.1 Objektivat e Manazhimit të Riskut

- ❖ Të kuptojë udhëzimet e riskut financiar dhe të biznesit të shoqërisë OSHEE SH.A..
- ❖ Të zhvillojë aftësinë për të identifikuar në kohë çështjet kritike.
- ❖ Të orientojë drejtuesit e lartë, që të fokusohen tek aktivitetet që gjenerojnë të ardhura.
- ❖ Të minimizojë në bazë ditore, humbjet që shkaktohen nga rishki operacional.
- ❖ Të kontrollojë dhe menaxhojë rritjen e shoqërisë.

- ❖ Të përmirësojë aftësitë për arritjen e objektivave të biznesit.
- ❖ Të hartojë metodologjitë dhe të ndihmojë strukturat e shoqërisë, në mënyrë që administrimin e riskut ta shikojnë si pjesë integrale të të gjitha proceseve të tjera.
- ❖ Vetëm pasi risqet janë analizuar, ato mund të trajtohen, kontrollohen dhe menaxhohen më mirë.

6.2.2 Përcaktimi i kontekstit

Përcaktimi i kontekstit ka të bëjë me përcaktimin e parametrave të jashtëm dhe të brendshëm, që shoqëria duhet të marrë në konsideratë kur administron Riskun. Konteksti i jashtëm i shoqërisë përfshin palët e jashtme të interesuara, mjedisin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe çdo faktor të jashtëm që ndikon në objektivat e saj. Konteksti i brendshëm i shoqërisë përfshin palët e brendshme të interesuara, qasjen e saj ndaj qeverisjes, marrëdhëniet kontraktuale, si dhe kapacitetet e saj, kulturën dhe standartet. Duhet të merret në konsideratë konteksti i shoqërisë, kur përcaktohet shtrirja e programit të menaxhimit të riskut, kur formulohet politika e administritimit të riskut, dhe kur përcaktohen kriteret e riskut.

6.2.3 Procesi i vlerësimit të Riskut

Vlerësimi i Riskut është një proces, i cili nga ana e tij përbëhet nga tre nën-proçese: Identifikimi i Riskut, Analiza e Riskut, dhe Vlerësimi i Riskut.

Identifikimi i Riskut është procesi që përdoret për të gjetur, njobur, dhe përshkruar risqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të një njësie organizative, apo të gjithë shoqërisë në tërësi.

Analiza e Riskut është një proces që përdoret për të kuptuar natyrën, burimet dhe shkaqet e risqeve që janë identifikuar, si dhe përcaktuar nivelin e riskut. Përdoret gjithashtu për të studiuar impaktet dhe pasojat, si dhe për të ekzaminuar kontrolllet që ekzistojnë aktualisht. Vlerësimi i Riskut është një proces që përdoret për të krahasuar rezultatet e Analizës së Riskut me Kriteret e Riskut, me qëllim që të vendoset nëse një nivel i caktuar risku, është i pranueshëm, apo i tolerueshëm.

6.2.4 Trajtimi i Riskut

Trajtimi i Riskut është Proçesi i Modifikimit të Riskut. Ai përfshin përzgjedhjen dhe implementimin e një apo më shumë mënyrave të trajtimit të Riskut. Pasi një trajtim është implementuar, ai shndërrohet në kontroll, ose modifikon kontrollet ekzistues. Mund të ketë shumë mënyra trajtimi të riskut. Risku mund shmanget, mund të reduktohet, mund të eleminohet burimin i tij, mund të modifikohen pasojat që e krijuan, mund të ndryshohet probabiliteti si dhe mund të ndahet me të tjera.

6.2.5 Komunikimi dhe konsultimi

Komunikimi dhe Konsultimi është dialogu mes shoqërisë dhe palëve të interesuara. Ky dialog është i vazhdueshëm dhe i përsëritshëm. Eshtë një proçes dydrejtësh, që përfshin edhe ndarjen, edhe marrjen e informacionit në lidhje me menaxhimin e riskut. Megjithatë, kjo nuk është vendim-marrje e përbashkët. Pasi konsultimi dhe komunikimi përfundon, vendimet merren dhe drejtimet përcaktohen nga shoqëria, dhe jo nga palët. Diskutimet mund të jenë për ekzistencën e risqeve, natyrën e tyre, formën, probabilitetin, dhe rëndësinë, si edhe nëse risqet janë apo jo të pranueshëm, ose duhet të trajtohen, dhe çfarë opsjonesh trajtimi duhet të merren në konsideratë.

6.2.6 Monitorimi dhe rishikimi

Monitorimi ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe vazhdimisht kontrollin dhe vëzhgimin. Kjo do të thotë të përcaktohet statusi aktual dhe të vlerësohet nëse nivelet e kërkuar apo të pritshëm të performancës, janë duke u arritur.

Rishikimi kryhet me qëllim që të vendoset nëse veprimi i ndërmarrë është i përshtatshëm, i duhuri dhe i efektshëm për të arritur objektivat e vendosur të njësisë ornagizative apo shoqërisë.

Në përgjithësi, duhet rishikar më specifisht dhe në vazhdueshmëri planet e Menaxhimit të Riskut si dhe Risqet, Kriteret e Riskut, Trajtimet e Riskut, Kontrollet, Risqet e Mbetur, dhe Proçesin e Vlerësimit të Riskut.

7. ANEKSET

ANEKS 1

Rregjistri i Riskut

Identifikim unik (Nr.)	Ky mund të jetë thjeshtë një titull, por edhe një emërtim përmes numrave mund të jetë i nevojshëm kur ke të bësh me një listë të gjatë risqesh
Risku (përshkrimi)	Paraqitur në format të strukturuar: Situata (Ekziston një risk që...) – Shkaku (I shkaktuar nga...) – Pasoja (Që rezulton në...)
Probabiliteti	Cilat janë gjasat që Risku të ndodhë? Do të ishte e dobishme të regjistrohej edhe justifikimi që qëndron prapa analizës
Impakti	Cili do të jetë impakti, nëse Risku ndodh? Do të ishte e dobishme të regjistrohej edhe justifikimi që qëndron prapa analizës
Statusi KVGJ (I Kuq, I Verdhë, I Gjelbër)	Bazuar në produktin e probabilitetit dhe impaktit, që nxirret sipas tabelës së miratuar të Analizës së Riskut
Shkalla kohore	Kur mund të ndodhë Risku? Cila është hapësira e manovrimit? Kur fillon të humbasësh opsione mbi mënyrën si do të reagosh?
Kostoja	Cila do të jetë kostoja që do të shkaktojë Risku, nëse ndodh? Këtë gjë nuk mund ta dish, nëse nuk di se cili do të jetë plani i veprimit për t'iu përgjigjur Riskut
Zotëruesi i Riskut	Drejtuesi i Njësisë, i cili ka për detyrë të “zotërojë” Riskun, domethënë që do të menaxhojë situatën, dhe do të garantojë kryerjen e veprimeve të nevojshëm nga ana e Zotëruesve të Proçeseve brenda njësisë së tij.
Qasja për menaxhimin e Riskut / Veprime për zbutjen e Riskut	Cilët janë veprimet e miratuar për të vepruar ndaj Riskut? <ul style="list-style-type: none"> • Veprime parandalues për të zbutur riskun • Veprime reagues, nëse Risku ndodh. Ky është “Plani i Impaktit”
Risku i mbetur	Ky është niveli i pritshëm i Riskut, pasi janë vënë në veprim të gjithë veprimet zbutës.



OPERATORI I SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE

DREJTORIA E QEVERISJES SË KOORPORATËS

Version 1.0

Shenjat e hershme
paralajmëruese

Cili është “alarmi” që do të paralajmërojë se Risku është duke ndodhur. Në disa raste, mund të vendoset që të ndërmerren veprime (psh shtohet financimi) vetëm pasi ka “rënë alarmi”

SHEMBULL RREGJISTRI I RISKUT

Nr. Id	Kategorizim i Riskut	Risku	Probabilitet i / Shkalla Cilat janë gjasat / probabiliteti që Riskut të ndodh?	Impakti Cili do të jetë impakti, nëse Risku ndodh?	Statusi KVGJ Bazuar në produktin e probabiliteti t dhe impaktit, që del nga tabelat e miratuar e analizës së Riskut	Shkalla kohore Kur mund të ndodhë Risku? Cila është hapësira e manovrimit ? Kur fillon të humbasësh opsiione mbi mënyrën si do të reagosh?	Kostoja Cila do të jetë kostoja që do të shkaktojë Risku, nëse ndodh? Këtë gjë nuk mund ta dish, nëse nuk di se cili do të jetë plani i veprimit përt'iu përgjigjur Riskut	Zotërues i i Riskut Drejtuesi i Njësisë, i cili ka përdetyrë të "zotërojë" Riskun.
SHEMBUL 1	Aftësitë	Aftësi të papërshtatshme, shkaktuar nga paftësia për të rekrutuar stafin e duhur	I ulët	I konsiderueshm	Verdhë	Gjatë gjithë kohës	Vonesa në realizimin e punës (mund të kostohet duke	Personi përgjegjës në Njësi
SHEMBUL 2	Aftësitë	Aftësi të papërshtatshme, shkaktuar nga paftësia për të rekrutuar stafin e duhur	I ulët	I konsiderueshm	Verdhë	Gjatë gjithë kohës	Vonesa në realizimin e punës (mund të kostohet duke	Personi përgjegjës në Njësi

DREJTORIA E QEVERISJES SË KOORPORATËS		Version 1.0
	që rezulton në probleme në punë	

	që rezulton në probleme në punë	I ulët	I konsiderueshm	Gjatë gjithë kohës	marrë parasysh kontekstini e Njësisë
Shembull 2	Menaxhim	Palët e interesuara nuk kanë kuptim të objektivave për shkak të mungesës së qartësisë	I konsiderueshm	Gjatë gjithë kohës	Voensa në projekt (mund të kostohet duke marrë parasysh kontekstini)
Shembull 3	Menaxhim	Mjedis jo i mirë, i shkaktuar nga mungesa e pajisjeve të duhura, që rezulton në atmosferë jo të mirë pune	Mesatar	I konsiderueshm	Voensa në projekt (mund të kostohet duke marrë parasysh kontekstini)

Aneksi 2 – Kategoritë dhe klasifikimet e riskut

Klasifikimi Sasior i Riskut

IMPAKTI	SHKALLA/PROBABILITETI I RISKUT					
	Shumë i ulët	I ulët	Mesatar	I lartë	Shumë i lartë	
I papranueshëm	V	K	K	K	K	
I konsiderueshëm		V	K	K	K	
I pranueshëm			V	K	K	
Minimal			V	V	K	
I papërfillshëm					V	

K	Nivel shumë i lartë i Riskut	Shpjegimi
V	Risk i Konsiderueshëm Risqe me mundësi të larta ndodhjeje	Ndikim në kosto, plan, dhe probleme teknike. Nevojë për një aksion real për të lehtësuar problemet. Kërkohet kujdes nga ana e drejtuesve
	Risk i ulët Risk minimal dhe i padëshirueshëm që të ndodhë	Ndikim minimal në kosto, plan, dhe probleme teknike. Një kujdes në nivel normal nga ana e drejtuesve është i mjaftueshëm

Impakti	Vlera
I papranueshëm	Mbi _____ Eur
I konsiderueshëm	Nga _____ në _____ Eur
I pranueshëm	Nga _____ në _____ Eur
Minimal	Nga _____ në _____ Eur
I papërfillshëm	Deri _____ Eur

Shkalla Probabiliteti	Frekuencia
Shumë i lartë	Më shpesh se një herë në muaj
I lartë	Një herë në dy muaj
Mesatar	Dy herë në vit
I ulët	Një herë në vit
Shumë i ulët	Më pak se një herë në vit

Klasifikimi Cilësor i Riskut

IMPAKTI	SHKALLA/PROBABILITETI I RISKUT					
	Shumë i ulët 1	I ulët 2	Mesatar 3	I lartë 4	Shumë i lartë 5	
I papranueshëm (5)	5	10	15	20	25	
I konsiderueshëm (4)		8	12	16	20	
I pranueshëm (3)		6	9	12	15	
Minimal (2)			6	8	10	
I papërfillshëm (1)					5	

K	Nivel shumë i lartë i Riskut	Shpjegimi
V	Risk i Konsiderueshëm Risqe me mundësi të larta ndodhjeje	Ndikim në kosto, plan, dhe probleme teknike. Nevojë për një aksion real përtë lehtësuar problemet. Kërkohet kujdes nga ana e drejtuesve
	Risk i ulët Risk minimal dhe i padëshirueshëm që të ndodhë	Ndikim minimal në kosto, plan, dhe probleme teknike. Një kujdes në nivel normal nga ana e drejtuesve është i mjaftueshëm

Impakti	Vlera
I papranueshëm	5
I konsiderueshëm	4
I pranueshëm	3
Minimal	2
I papërfillshëm	1

Shkalla Probabiliteti	Frekuencia
Shumë i lartë 5	Më shpesh se një herë në muaj
I lartë 4	Një herë në dy muaj
Mesatar 3	Dy herë në vit
I ulët 2	Një herë në vit
Shumë i ulët 1	Më pak se një herë në vit

Aneksi 3 – Risku Operacional – Saktësime dhe shembuj konkret.

RISIKU OPERACIONAL		
Mashtrim i Jashëm	Mashtrim i Jashtëm dhe Vjedhje (për qëllime fitimi)	<ul style="list-style-type: none"> Vjedhje / grabitje / zhvatje / përvetësim • Forgery Shpërdorim asetesh Shtirje
	Mashtrim me bazë IT, & vjedhje, nga faktorë të jashtëm	<ul style="list-style-type: none"> Dëm nga Hacker-imë Vjedhje informacioni (me humbje monetare për njësinë) Dëm I shkaktuar nga "Phishing" (përdorim emailesh të rremë)
Mashtrim i Brendshëm	Mashtrim i brendshëm dhe vjedhje	<ul style="list-style-type: none"> Mashtrim / mashtrim krediti Vjedhje / zhvatje / përvetësim / grabitje Shpërdorim i aseteve Falsifikim Kontrabandë Ndryshim identiteti Mospagim taksash / evazion (i qëllimshëm) Rryshfete / haraçe Tregti të brendshme (jo për llogari të kompanisë)
	Aktivitet i paautorizuar	<ul style="list-style-type: none"> Transaksione të paraportuara (qëllimi) Lloji i transaksionit i paautorizuar (me humbje monetare për njësinë), si transaksionet e pamiratuar Autorizim i pavlefshëm i ekspozimit
	Mashtrim i brendshëm dhe vjedhje përmes IT	Përfitimi monetar është parakusht
Dëmtim i qëllimshëm dashakeq	Dëm i qëllimshëm	Dëmtim I qëllimshëm kryer prej vandalizmit, duke përjashtuar ngjarje që lidhen me sistemin e sigurisë
	Terrorizëm	Akte spiunazhi industrial dhe terrorizmi
	Dëmtim i jashtëm, i qëllimshëm i sistemeve të sigurisë	Përfshin ngjarje të sigurisë të sistemeve të jashtëm të një natyre të qëllimshme, jo për fitim (psh përhapje virushesh, programesh kompjuerikë etj), që bëhen nga një pale e tretë, pa ndihmën e një pale të brendshme
	Dëmtim i brendshëm, i qëllimshëm i sistemeve të sigurisë	Përfshin ngjarje të sigurisë të sistemeve të jashtëm të një natyre të qëllimshme, jo për fitim (psh përhapje virushesh, programesh kompjuerikë etj), që përfshijnë të paktën një pale të brendshme

Praktika punësimi dhe siguria në vendin e punës	Marrëdhëniet me punonjësit	<ul style="list-style-type: none"> Kompensime, përfitime, çështje përfundimi të punësimit Aktivitete të organizuar (greva)
	Mjedis i sigurtë në vendin e punës	<ul style="list-style-type: none"> Rregullat e shëndetit dhe sigurisë për punonjësit; Kompensime për punonjësit
	Diversiteti dhe diskriminimi	<p>Ne dallojmë ngjarjet e diskriminimit në vendin e punës nga ngjarjet publike të diversitetit apo diskriminimit, që përfshijnë klientët apo qytetarët në përgjithësi;</p> <ul style="list-style-type: none"> Shkelje të mirëbesimit Çështje të përshtatshmëris/hapjes (mbledhje informacionesh papërshtatshmërie gjatë procesit, etj.) shkelje të sekretit të info të klientit Shkelje e privatësisë Shitje agresive Keqpërdorim i informacionit konfidencial Detyrimet e huadhënësит Mbfaturim i klientëve
Klientë, produkte dhe praktika biznesi	Përshtatshmria, Hapja dhe Mirëbesimi	<ul style="list-style-type: none"> Antitrust/kartel Tregti e gabuar / praktika tregu; Manipulim tregu; Tregti e brendshme (në llogarinë e kompanisë); Vepripmtari e palicencuar; Pastrim parash; Ngjarje diskriminimi / diversiteti në treg apo publik; Shkelje e kushteve themelore të biznesit
	Praktika të gabuara biznesi, apo tregu	<ul style="list-style-type: none"> Aksidente (si me makinat e kompanisë), që mund të përfshijnë lëndime të jo-punonjësve Rrëshkitje apo rrëzime të jo-punonjësve Humbje për shkak të shkeljeve të sigurisë publike (asbest në mure, moskontrollim I ndotjes etj.).
Fatkeqësítë dhe Siguria Publike	Fatkeqësi dhe ngjarje të tjera	Humbje nga fatkeqësi natyrore
	Aksidente dhe siguria publike	<ul style="list-style-type: none"> Aksidente (si me makinat e kompanisë), që mund të përfshijnë lëndime të jo-punonjësve Rrëshkitje apo rrëzime të jo-punonjësve Humbje për shkak të shkeljeve të sigurisë publike (asbest në mure, moskontrollim I ndotjes etj.).
Teknologji dhe dështimet e infrastrukturës		<ul style="list-style-type: none"> Kompjutera; Programe kompjuterike; Telekomunikacion; Ndërperje të energjisë
Ekzekutim, Shpërndarje dhe Menaxhim Proçesesh	Gabime njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> Mungesë komunikimi Gabim në futje të dhënavat, mirëmbajtje Gabim në llogari Gabime të tjera në kryerje detyrash Mospërbushje e detyrave
	Menaxhim të dhënavat	<ul style="list-style-type: none"> Migrim i pasaktë i të dhënavat të mëparshme Ndarje e papërshtatshme e sistemeve të testimit dhe sistemeve "live" Zëvendësim i pasaktë i dokumentave
	Monitorim dhe raportim	<ul style="list-style-type: none"> Mospërbushje e detyrimit të raportimit Raporte të jashtëm të pasaktë (me shkaktim humbjes)

I. Risku i procesit

Menaxhim Operacionesh

Ky përfishin gabinet në transaksione, gabime dhe elementinë (fshirje) që ndodhin kudo në ciklin e jetës së transaksionit. Krijimi i proceseve, të gjithë procedurat e nevojshme, Workflow-t, ndërveprimi me departamentet e tjerë. Ai përjashton të dhënat e gabarata themelore (gabime njërezoresh). Këto humbe mund të ndodhin vetëm gjatë një transakzioni.

Zbulimi i Raportimit
Merret specifisht me krijimin dhe ruajtjen e të dhënave, si dhe sigurimin në kohën e duhur të dhënave cilësore, në mjetin e procesit. Ky ka një impakt specifik në përdorimin e të dhënave të pasakta apo të papërshtatshme, brenda ciklit të procesit

Infrastruktura dhe sistemet
Ky përstikruan dështim në kryerjen, ose mohimin e shërbimit në sistemet e brendshëm dhe infrastrukturë (ngar/brenda), duke përfshirë ndërveprimet dhe hyrjet brenda dhe jashtë një institucionit. Impakti mated ne lidhje me natyren e procesit, sa i përkert varësish së tij ndaj kohës, duke përfshirë një mekanizëm rikthimi në normalitet në rast fatkeqësisë/katastrofash.

II. Risku i Siellies

I mirebesimit

Mospërmbylja nga një punonjës apo agjent i të gjithë përgjegjësive të kësia, që ka një kontratë apo aseteve, shkaktuar nga mirebesimi dhe dehydratimi i tij. Ky përfishin nxjerrjen e informacioneve të rendësshëm jashtë kompanisë.

Praktika të papërshtatshme
Kur punonjësi, agjenti apo vjetë kompania nuk arrinë të kryejnë derbynimet, sipas kontratës apo aseteve, shkaktuar nga një akt i gjallësimshëm nga një palë e jashtme. Ky kategori i riskut përfshin aktet të spionazhit industrial dhe terroristit. Përfishin gjithashu staf të larguar nga puna, që mund të përcorë informacione kundër kompanisë.

Veprrintari Tregu e Paautorizuar
Përmes lojeve të paautorizuar të transaksioneve ose produkteve, dhe fshijës e qëllimshme e transaksioneve të përmbyllura. Specifisht bën fjalë për "tregimi i mashtruese" dhe fshijen e qëllimshme, por përgjashonitë hilaretë.

Infrastruktura dhe sistemet
Ky përstikruan dështim në kryerjen, ose mohimin e shërbimit në sistemet e brendshëm dhe infrastrukturë (ngar/brenda), duke përfshirë ndërveprimet dhe hyrjet brenda dhe jashtë një institucionit. Impakti mated ne lidhje me natyren e procesit, sa i përkert varësish së tij ndaj kohës, duke përfshirë një mekanizëm rikthimi në normalitet në rast fatkeqësisë/katastrofash.

III. Riski i Jashtëm

Falje qësia Natyrore dhe Akident

Dëmit ndaj ose humje e aseteve, shkaktuar nga një ngjarje natyrore ose akident.

Dëmtim me qëllim
Dëmtim ndaj, ose humje e aseteve, shkaktuar nga një akt i gjallësimshëm nga një palë e jashtme. Ky kategori i riskut përfshin aktet të spionazhit industrial dhe terroristit. Përfishin gjithashu staf informacione kundër kompanisë.

Hacker-i i dñe ndërprerje
Aksesa i jashtem i paautorizuar ose manipulimi, apo ndërprerje e sistemeve, infrastrukturës ose të dhënave, duke përfshirë mohimin të sulmeve ndaj shërbimit. Merr në konsideratë etzistencën e infrastrukturës dieleksore të IT-ës organizatit.

Mashtrimi dhe Vjedhje e Jashtme
Të gjithë format e shpërdorimit nga jashtë të aseteve, përmes vjedhjes apo mashtrimit.

Diversiteti dhe Diskriminimi
Mos përpunohet me rregullat dhe udhëzimet që lidhen me diversitetin dhe/ose indixriminimin e punonjësve ose agjentëve.

Marrëdhënie i punonjësve
Gjevat dhe të gjithë format e aktionsit industrial nga punonjësit ose agjentët, apo vdojët e punonjësve ose agjentët që kanë ndërprerje të punës, apo rrjet të pakohësisë së konsumatorit (sabotazi i brendshëm). Përfishin mungesën e statit për perifidha të calitara kohë, që con në ndërprerje të punës, për shkak se nuk ka staf të mifustësh përfi zhvendësuar.

Mjedisi i sigurtë
Mospërpunohet me rregulloret dñe udhëzimet që lidhen me shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, agjentëve dhe paëve të treta brenda vendit të punës. Përfishin rreziqet dhe këndime nga paëtë jashtme.

8. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- Ligji Nr 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
- Statuti i shoqërisë “Operatori i Shpërendarjes së Energjisë Elektrike” sh.a.
- Ligji Nr.10 296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”.
- Urdhëri i Ministrit të Financave Nr.8980 dt.15.07.2010 “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Standartet ISO 31000 per administrimin e riskut.

 OSHEE OPERATORI I SHPËRNDAJES SE ENERGIJE SË ELEKTRIKE	DREJTORIA E QEVERISJES SË KOORPORATËS	Version 1.0
--	---------------------------------------	-------------

9. HISTORIKU I RISHIKIMEVE TË DOKUMENTIT

Data efektive	Nr. Rishikimeve	Autori	Pëshkrim i ndryshimeve të bëra në dokument
__ / __ /201 __ *	0		Dokument i ri

* Data efektive në rreshtin e parë të tabelës është data e aprovimit të parë të dokumentit. Datat në rreshtat në vijim do t'i referohen datës së aprovimit të rishikimeve të dokumentit për modifikime të ndryshme.